

VENDIM
DATË 04 / 09 / 2025
I ASAMBLESË SË PËRGJITHSHME TË ORTAKËVE
TË SHOQËRISË "A.T. ORICUM" SHPK

Sot, më datë 04.09.2025, në selinë e shoqërisë "A.T. Oricum" shpk, në adresën: Vlorë, Rruga "Aleksander Moisiu", Nr. 48, u mbajt mbledhja e Asamblesë së Përgjithshme të Ortakëve të shoqërisë "A.T. Oricum" shpk, regjistruar pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit me NUIS L819130020. Në këtë mbledhje janë të pranishëm ortakët e shoqërisë, si në vijim:

- Z. Eraldo Sheko, i cili zotëron 49 % të kapitalit të shoqërisë "A.T. Oricum" shpk;
- Znj. Ela Puka, e cila zotëron 51 % të kapitalit të shoqërisë "A.T. Oricum" shpk.

Në bazë të nenit 86 dhe 87 të ligjit nr. 9901, datë 14.04.2008 "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare", i ndryshuar, mbledhja konsiderohet e rregullt.

Rendi i ditës në mbledhjen e sotme është si më poshtë:

1. Ndryshimin e nenit 8 "Transferimi i kuotave", të Statutit të shoqërisë, me përmbajtjen si në vijim:

"8.1. Ortakët mund t'ja shesin të tretëve kuotën e tyre të kapitalit tërësisht apo pjesërisht, por pasi të kenë marrë miratimin e asamblesë dhe pasi t'ua kenë ofruar për blerje ortakëve brenda shoqërisë me kushte të njëjta nga ato që t'ju ofrohen të tretëve. Njoftimi u komunikohet me shkrim ortakëve të cilët kanë të drejtën e parablerjes, e drejtë e cila duhet të ushtrohet brenda 60 ditëve nga data e komunikimit, në të kundërt njoftimi do të konsiderohet i refuzuar prej ortakëve që gëzojnë këtë të drejtë.

8.2. personi që kalon kuotën dhe ai që e fiton atë, përgjigjen në mënyrë solidare ndaj shoqërisë për detyrimet që rrjedhin nga zotërimi i kuotës, nga çasti i kalimit të kuotave, deri në çastin e regjistrimit të kalimit, sipas nenit 74, të ligjit nr. 9901, datë 14.04.2008 "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare", i ndryshuar."

2. Ndryshimin e pikës 10.3, të nenit 10 të Statutit të shoqërisë, me përmbajtjen si në vijim:

"10.3. Asambleja e përgjithshme, mund të marrë vendime të vlefshme vetëm nëse marrin pjesë ortakët me të drejtë vote, që zotërojnë me shumë se 50% të kuotave."


3. Shtimi i pikës 10.8, në nenin 10 të Statutit të shoqërisë, me përmbajtjen si në vijim:

"10.8. Ortakët mund të marrin pjesë në mbledhjen e asamblesë së përgjithshme dhe nëpërmjet mjeteve elektronike të komunikimit si, zoom, apo aplikacione të ngjashme."

4. Të ndryshme.

Asambleja e Përgjithshme e Ortakëve, pasi diskutoi çështjet e rendit të ditës:

VENDOSI:



1. Ndryshimin e nenit 8 "Transferimi i kuotave", të Statutit të shoqërisë, me përmbajtjen si në vijim:

"8.1. Ortakët mund t'ja shesin të tretëve kuotën e tyre të kapitalit tërësisht apo pjesërisht, por pasi të kenë marrë miratimin e asamblesë dhe pasi t'ua kenë ofruar për blerje ortakëve brenda shoqërisë me kushte të njëjta nga ato që t'ju ofrohen të tretëve. Njoftimi u komunikohet me shkrim ortakëve të cilët kanë të drejtën e parablerjes, e drejtë e cila duhet të ushtrohet brenda 60 ditëve nga data e komunikimit, në të kundërt njoftimi do të konsiderohet i refuzuar prej ortakëve që gëzojnë këtë të drejtë.

8.2. personi që kalon kuotën dhe ai që e fiton atë, përgjigjen në mënyrë solidare ndaj shoqërisë për detyrimet që rrjedhin nga zotërimi i kuotës, nga çasti i kalimit të kuotave, deri në çastin e regjistrimit të kalimit, sipas nenit 74, të ligjit nr. 9901, datë 14.04.2008 "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare", i ndryshuar."

2. Ndryshimin e pikës 10.3, të nenit 10 të Statutit të shoqërisë, me përmbajtjen si në vijim:

"10.3. Asambleja e përgjithshme, mund të marrë vendime të vlefshme vetëm nëse marrin pjesë ortakët me të drejtë vote, që zotërojnë me shumë se 50% të kuotave."

3. Shtimin e pikës 10.8, në nenin 10 të Statutit të shoqërisë, me përmbajtjen si në vijim:

"10.8. Ortakët mund të marrin pjesë në mbledhjen e asamblesë së përgjithshme dhe nëpërmjet mjeteve elektronike të komunikimit si, zoom, apo aplikacione të ngjashme."

4. Të ndryshme.

**ASAMBLEJA E PËRGJITHSHME E ORTAKËVE
SHOQËRIA "A.T. ORICUM" SHPK
ORTAKËT**

Znj. Ela Puka

Z. Eraldo Sheko

Ela Puka

Eraldo Sheko